




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-15826/21 datë:05.07.2021



Npi – 01/205 datë: 14.07.2021

Bazuar në nenin 12.2 pika (d) si dhe neni 17 pika (p) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Rregulloren e MAPL Nr.01/2017 për procedurën e hartimit dhe publikimin e Akteve të Komunës; Si dhe duke marrë parasysh kërkesën e Ministrisë të Pushtetit Lokal Nr. 020-534-7-2021 dt. 22.06.2021 për rishqyrtimin e vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01-151 për vendosjen e shtatores së “Adem Jashari” në Shtime, Kuvendi Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 14.07.2021 aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR KONFIRMIMIN E VENDIMIT Npi-01/151 PËR VENDOSJEN E SHTATORES TË KOMANDANTIT LEGJENDAR TË UÇK “ADEM JASHARI “ NË SHESHIN (TREKËNDËSHIN) E QYTETIT TË SHTIMES

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -VII- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më: 14.07.2021, unanimisht vendosi të konfirmojë, se qëndron pranë vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes Npi-0/151 të datës: 03.06.2021, për vendosjen e shtatores të Komandantit Legjendar të UÇK “Adem Jashari “ në Sheshin (trekëndëshin) e qytetit të Shtimes.

II

A r s y e t i m: Vendimi Npi-0/151 i datës: 03.06.2021, për vendosjen e shtatores të Komandantit Legjendar të UÇK “Adem Jashari“ në Sheshin (trekëndëshin) e qytetit të Shtimes, është i bazuar duke marrë parasysh kompetencat e Kuvendit nga neni 17 i Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040; Si dhe Vendimin e Kuvendit Npi-01/105 dt. 20.04.2021 për diskutim publik me qytetarë për vendosjen e shtatores se Adem Jasharit në Shtime, meqenëse Plani Zhvillimor Komunal nuk e precizon lokacionin se ku duhet të vendoset një shatore, ose simbol tjetër përkujtimor.

III

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

IV

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Drejtorive, Kryesueses së Kuvendit, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushteti Lokal, dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj